

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, përmes gjyqtarës së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të akuzuarve O.M. nga ..., L.K.1. nga ..., R.K. nga ..., L.K.2. nga ... dhe, E.L. nga ..., për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187.paragr.1 lidhur me paragr. 31 KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II.nr.2257/17 të datës 30.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt. 15.02.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I. I akuzuari **O.M.** nga babai H. dhe nëna M. – I., i lindur më dt. ..., në ..., jeton në fsh. ..., i arsimuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

II. I akuzuari **L.K.1.** nga babai B. dhe nëna R. – D., i lindur më dt. ..., në ..., jeton në fsh. ..., i arsimuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, me profesion kamarier – i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

III. I akuzuari **R.K.** nga babai H. dhe nëna M.– H., i lindur më dt. ..., në ..., jeton në fsh. ..., i papunë, i arsimuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

IV. I akuzuari **L.K.2.** nga babai A. dhe nëna H. – Sh., i lindur më dt. ..., në ..., jeton në fsh. ..., i papunë, i arsimuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

V. I akuzuari **L.L.** nga babai E. dhe nëna H. – G., i lindur më dt. ..., në ..., jeton në fsh. ..., i arsimuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

JANË FAJTORË

I

Të pandehurit O.M. dhe L.K.

Sepse më dt. 03.11.2017 rreth orës 23:10 minuta në ..., në restorantin “ ... ”kanë sulmuar të demtuarit – pabndehurit R.K., L.K.2. dhe E.L., në atë mënyrë që derisa të pandehurit në të njëjtën kohë ishin ulur në një tavolinë, lidhur me vendin e zënë, kishin filluar mosmarrëveshjet verbale mes tyre, e më pas kishte ardhur edhe deri te kontakti fizik, me ç’rast të pandehurit duke përdorë forcën me grushte dhe shqelma i godasin tani të demtuarit R.K., L.K.2. dhe E.L., nëpër pjesë të ndryshme të trupit.

- me çka kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187 paragr.1 lidhur me nenin 31 KPRK.

Të pandehurit R.K., L.K.2. dhe E.L.

Në ditën, vendin dhe kohën e përshkruar në dispozitivin e parë të aktakuzës, i sulmojnë të dëmtuarit – pandehurit O.M. dhe L.K.1., në atë mënyrë që pas mosmarrëveshjeve dhe fyerjeve që kishin pasur mes veti, kishte ardhur edhe deri te kontakti fizik, ashtu që të pandehurit e lartcekur duke përdorë forcën, me grushte dhe shqelma i godasin tani të dëmtuarit O.M. dhe L.K.1., nëpër pjesë të ndryshme të trupit.

- me çka kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187 paragr.1 lidhur me nenin 31 KPRK.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4,7,17,40,41,42,46,73 dhe 74 KPRK si dhe nenit 248 dhe 365 KPPK

I GJYKON

I. ME DËNIM GJOBE në shumë prej nga 100 (njëqind) € për secilin të akuzuar veç e veç, të cilin dënim të akuzuarit janë të obliguar ta paguajnë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, në të kundërtën gjykata të njëjtin dënim do t'ua zëvendësoj me dënim burgu, ashtu që një ditë burgu do të llogaritet 20 €.

II. Të akuzuarit obligohen që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 € si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit..

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan ka ngritë aktakuzën kundër të akuzuarve O.M. nga ..., L.K.1. nga ..., R.K. nga ..., L.K.2. nga ... dhe, E.L. nga ..., për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187.paragr.1 lidhur me paragr. 31 KPRK, me propozim që gjykata të akuzuarit t'i shpallë fajtor dhe ta ndëshkoj sipas ligjit.

Gjatë seancës fillestare të mbajtur më dt. 15.02.2018, në të cilën është lexuar aktakuza e prokurorit të shtetit PP.II.nr. 2257 të dt. 30.11.2017, pas leximit të aktakuzës të pandehurit O.M., L.K.1., R.K., L.K.2. dhe E.L., deklaruan se e kanë kuptuar aktakuzën dhe veprën penale e cila u vihet në barrë, duke shtuar se e pranojnë fajësinë për kryerje të kësaj vepre penale, të gjithë të pandehurit janë pajtuar mes veti, e kjo është vërejtur gjatë seancës, i kanë kërkuar falje njëri tjetrit, tani kanë raporte të mira dhe i kanë premtuar gjykatës se nuk do të kryejnë vepra të tilla apo çfarë do lloji vepre tjetër.

Në seancën fillestare, gjykatësja e vetme pas deklarimit të palëve mori Aktvendim me të cilin aprovoi pranimin e fajësisë, për shkak se për këtë janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore. Në këtë aspekt gjykatësja e vetme konstatoi se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë me vullnetin e tyre, se pranimi i fajësisë përmban të gjitha faktet të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Konform kësaj, gjykatësja e vetme gjykuese vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehurit O.M. nga ..., L.K.1. nga ..., R.K. nga ..., L.K.2. nga ... dhe, E.L. nga ..., kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187.paragr.1 lidhur me paragr. 31 KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Me nenin 187 paragr.1 lidhur me nenin 31 KPRK është paraparë:” Kushdo që me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër, pa pëlqimin e atij personi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”.

Në bazë të cekurave të mësipërme, gjykata vendosi që të pandehurit t'i shpallë fajtorë për kryerjen e veprës penale, asi që në veprimet e të njëjtëve përmbahen të gjitha elementet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën vepër janë penalisht përgjegjës.

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 KPRK me rastin e shqiptimit të dënimit kundër të akuzuarve, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, kështu që nga rrethanat lehtësuese për të pandehurit mori parasysh faktin se janë të moshës së re, se deri më tani nuk kanë qenë të gjykuar, se janë pajtuar mes veti, pendohen për kryerjen e veprës penale duke premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejnë çfarë do vepre tjetër penale. Rrethana rënduese nuk ka pasur.

Sipas bindjes së kësaj gjykate shqiptimi i dënimit me gjobë kundër të pandehurve është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve.

Gjykatësja e vetme gjykuese konstatoi se me këtë lloj të dënimit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit nga neni 41 KPRK që të pandehurit në të ardhmen të mos kryejnë vepra tjera penale, t'i parandaloj personat tjerë në kryerjen e veprave penale dhe të paraqes gjykimin shoqëror për veprën penale, të rris moralin dhe fuqizoj obligimin për të respektuar ligjin.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është bazuar në nenin 453 KPPRK.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1304/2017 më dt. 15.02.2018**

**Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçević**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Snezhana Mihajloviq**

UDHËZIMI JURIDIK: *Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.*

**Përktheu –
Naile Keçmezi**

